



E nderuara znj. Ministre,
I nderuari z. Majk,
I nderuari z. Berisha
Të nderuar të pranishëm

Është kënaqësi e veçantë të jem pjesë e kësaj ceremonie që shënon një hap shumë të rëndësishëm të lansimit të Dritares së Eksportit. Më lejoni që në emër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të përgëzoj Fondin Kosovar për Garanci Kreditore dhe USAID-it (Kosovo Compete Activity) për lansimin e dritares së re për lehtësim financiar të quajtur “Dritarja e Eksportit”.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, me përkrahjen edhe të miqve tanë ndërkombëtar, brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore ka arritur të shndërrohet në një institucion shumë të rëndësishëm, duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në rritjen dhe lehtësimin e financimit për ekonominë e vendit.

Kreditimi bankar vazhdon të jetë një burim shumë i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm i financimit të sektorit privat në Kosovë. Vlera e kredive të sektorit bankar deri në muajin tetor 2022 ka arritur në 4.3 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 17.9%.

Sidoqoftë, me gjithë trendin e kënaqshëm të rritjes së kreditimit bankar, konsiderohet se shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë duhet të rritet edhe më tej, dhe se në raport me madhësinë e ekonomisë, ekziston hapësirë e mëtejme për zgjerim të aktivitetit kredidhënies.

Rol të rëndësishëm në plotësimin e kësaj hapësire ka pikërisht Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, i cili përmes mekanizmit të tij garantues do të mundësojë rritjen

e kreditimit dhe lehtësimin e kushteve të qasjes në kredi edhe për sektorët me rëndësi të jashtëzakonshme që sigurojnë zhvillim ekonomik të vendit.

Dritarja e re për eksport, që ka për synim lëshimin e garancive të reja për institucionet financiare partnere në dobi të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, veçanërisht për bizneset e fokusuara në eksport, është një lajm i mirë për bizneset por edhe ekonominë e vendit.

Në këtë periudhë ku ekonomia jonë, dhe jo vetëm, ka pasur ndikime negative, fillimisht nga pandemia dhe së fundmi edhe nga agresioni rus në Ukrainë, është shumë me rëndësi që të ndihmohen ndërmarrjet tona, për të rritur sa më shumë eksportin.

Deri në tetor të këtij viti, vlera e eksporteve arriti në shumën prej 774.4 milionë euro.

Kjo shumë paraqet një rritje mbi 160 milionë euro në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021.

Megjithatë, kjo rritje është ende e ulët krahasuar me importin që në periudhën e njëjtë janar-tetor 2022 ka arritur shumën prej 4.6 miliardë euro.

Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar importet ishin në shumën prej 3.7 miliardë euro.

Andaj, kjo dritare e re do të ndihmojë në rritjen e eksportit të bizneseve, duke kontribuar në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdon të mbështesë dhe të shtyjë sektorin financiar në rritjen e mbështetjes ndaj ekonomisë e sidomos bizneseve që kanë për qëllim eksportin e produkteve tona.

Ju faleminderit!